

EKSPLORUESI I GJUHËS

LISTA PËR TË VLERËSUAR AFTËSINË NË GJUHËN TUAJ



Ky projekt është financuar me ndihmë nga Komisioni Evropian.
Ky publikim reflekton vetëm pikëpamjet e autorit, dhe Komisioni nuk mund të jetë përgjegjës për asnjë lloj përdorimi që mund t'i bëhet informacionit që përfshihet këtu.

Ky eksplorues i përket:

Emri: _____

HYRJA

Ky Eksplorues i gjuhës është krijuar të përdoret nga njerëz me prejardhje migrante. Ai ndjek principet e Portofolit të Gjuhëve Evropiane (shiko www.coe.int/portfolio) - i cili dokumenton dhe ilustron përvojat dhe arritjet në mësimin e gjuhës.

Eksploruesi i gjuhës përdoret kryesisht për të përshkruar aftësinë e personit në ato gjuhë që ai ose ajo dinë përpara se të mbërrijnë në shtetin pritës, për shembull gjuha/gjuhët e folur(a) në familje apo në fqinjësi ose ato në të cilat ai ose ajo janë edukuar në shkollë. Ai regjistron gjuhët në të cilat personi ka aftësi dhe nivel specifik zotërimi në një numër fushash të ndryshme. Fokuset në veçanti në gjuhët e përdorura në shtëpi, në punë, në shkollë dhe në komunitet.

Njohja e gjuhës përcaktohet nga niveli i zotërimit siç përshkruhet në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencës së Gjuhëve: Mësimi, Mësimdhënia, Vlerësimi (CEFR). Shkalla është ilustruar në faqet 2 deri 4.

Eksploruesi i gjuhës u krijua nëpërmjet projektit "ShowMi - Të ndihmojmë migrantët të tregojnë vlerat e gjuhëve të tyre". Projekti u financua nga Programi i Mësimi Gjatë Gjithë Jetës dhe është organizuar nga 2009 deri 2011.

Për më shumë informacion shikoni www.showmiproject.eu

SI TË PËRDORNI PASAPORTËN TUAJ TË EKSPLORESIT TË GJUHËS





- Filloni me Pasaportën tuaj
- Zgjidhni gjuhët që doni të vlerësoni tek faqja "Gjuhët e mia"
- Zgjidhni fushat tematike: Shëndetësi, Jeta e përditshme, Puna, etj
- Tani shkoni tek Eksploruesi i Gjuhës
- Shikoni shpjegimet për tre nivelet (A, B, C) në faqet 2 - 4
- Shkoni tek fusha e parë që keni zgjedhur për vlerësim
- Shikoni përshkruesin (p.sh. "Unë mund të flas për veten time"). Shikoni shembujt poshtë dhe vini shenjë tek ato që ju përkasin në fushat e ndryshme të aftësive: dëgjimi, e folura, shkrimi ose leximi. Secili shembull i përket një niveli të caktuar (shikoni shembujt poshtë që t'ju japin një ide).

| Rreth meje | Fusha ime e kompetencës | | | | Niveli i përdorimit të gjuhës |
|--|-------------------------|---------|--------|---------|-------------------------------|
| | E folura | Dëgjimi | Leximi | Shkrimi | |
| 3. Unë mund të flas rreth familjes dhe miqve të mi. | | | | | |
| p.sh., unë mund të them emrat e familjes time. Unë mund të them se çfarë pamje kanë nga janë dhe çfarë bëjnë. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | A |
| p.sh., unë mund të them emrat e pjesëtarëve të familjes time dhe miqve të mi: pamjen e tyre, karakterin e tyre dhe ekzakhtësisht se çfarë bëjnë ata. | ✓ | ✓ | ✓ | | B |
| p.sh., unë mund të përshkruaj personalitetin e pjesëtarëve të familjes time dhe të miqve të mi, duke bërë krahasime dhe duke përdorur humor. | | | | | C |

- Ju mund të shtoni shembujt tuaj
- Vini re se niveli juaj në secilën fushë mund të jetë i ndryshëm!
- Vini re se niveli juaj në secilën fushë aftësie (dëgjim, të folur, etj.) mund të jetë i ndryshëm

- Pasi të keni vlerësuar gjuhët tuaja tek Eksploruesi mund plotësoni aftësitë tuaja tek Pasaporta - nëse nuk jeni të sigurt se ç'duhet të bëni, pyesni trajnuesin ose këshilltarin tuaj
- Nuk keni nevojë të plotësoni të gjitha fushat (p.sh. puna, shëndeti). Plotësoni vetëm ato që kanë të bëjnë me ju.

Shembull pasaporte:

| |  |  |  |  |
|-------------------|---|---|--|---|
| Fushat | Dëgjimi/Kuptimi | E folura | Leximi | Shkrimi |
| Rreth meje | A B C <input type="text"/> | A B C <input type="text"/> | A B C <input type="text"/> | A B C <input type="text"/> |